



609	XHAFER	ISLAM	BARI	69	SHKODER	8591	12/456	82.0	8,500	697,000.0
610	ESAT	BRAHIM	BUSHATI							
611	MINIRE	BRAHIM	BUSHATI							
612	MUSA	BRAHIM	BUSHATI	70	SHKODER	8594	8/225	284.5	10,831	3,081,419.5
613	ZYHNIJE	BRAHIM	BUSHATI							
614	GJYLYZE	BRAHIM	BUSHATI							
615	SHEMSIJE	HALIL	KALI							
616	KUJTIME	HALIL	KALI							
617	IKBALE	IBRAHIM	KALI							
618	SABAHETE	NAZMI	KALI	71	SHKODER	8592	4/548	4.4	9,908	43,595.2
619	SADIJE	ALI	KALI							
620	ALMA	FAHRI	KALI							
621	ERVIOLA	FAHRI	KALI							
								888.1	Shuma	8,946,432.3
								232,252.7	SHUMA TOT.	450,233,706.6

VENDIM

Nr. 911, datë 11.11.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE E PAGESAVE DHE PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, PËR NXËNËSIT E STUDENTËT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2015–2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar,

si dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR).

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënësit që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km dhe studentët që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 10 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre e që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Nxënësit që banojnë në fshat, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që akomodohen në konvikte publike dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që akomodohet në konvikte publike dhe plotëson kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjetë);

b) Nxënësit që vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në drejtimet mësimore: Bujqësi,



Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe të gazit, në vitet e treta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë);

c) Studentët e regjistruar në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga MAS-i më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit, të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Për vitin akademik 2015–2016, numri i tyre do të jetë 30 (tridhjetë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin akademik 2015–2016;

ç) Studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, që kanë përfunduar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjetë);

d) Studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në degët Matematikë dhe Fizikë, në vitin e dytë e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënës dhe studentë që kanë përfituar statusin e jetimit;

b) Nxënës dhe studentë që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë;

c) Nxënës dhe studentë që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;

ç) Nxënës dhe studentë që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;

d) Nxënës dhe studentë, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit e përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera;

dh) Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian, që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;

e) Nxënës dhe studentë që janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ë) Fëmijët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

Në fillim të çdo viti akademik, por jo më vonë se data 15 dhjetor 2015, për këto kategori nxënësish/studentësh, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, si dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë listën e nxënësve/studentëve përfitues, sipas pikës 2.3, të këtij vendimi.

2.4 Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit:

a) Nxënësit e shkollave profesionale që ndjekin drejtimit mësimore: Bujqësi, Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe të gazit;

b) Nxënësit e shkollave profesionale, që ndjekin drejtimit mësimore profesionale, me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Pogradec, Skrapar dhe Tepelenë.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në kuotat e miratuara në këtë vendim, për studentët që regjistrohen dhe ndjekin vitin e parë akademik 2015–2016 harton planin e shpërndarjes së bursave, sipas njësive arsimore vendore (DAR) dhe zyrave arsimore (ZA). Njësitë arsimore vendore, mbështetur në numrin e studentëve që ndjekin vitin e parë akademik 2015–2016, si dhe kërkesave zyrtare të njësive bazë të qeverisjes vendore, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave për kategoritë sipas pikave 2.1 e 2.3, të këtij vendimi, dhe e dërgojnë atë në njësitë bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 15.11.2015.

5. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pas këshillimit me njësitë bazë të qeverisjes vendore ku ndodhen shkollat profesionale, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e shkollave profesionale që regjistrohen dhe ndjekin vitin e parë akademik 2015–2016 dhe ua dërgon, për



miratim, njësisive bazë të qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale të shkollave profesionale, jo më vonë se data 15.11.2015.

6. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to, vendosin/miratojnë, me vendim të këshillit të bashkisë, dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve/studentëve nga shtresat/kategoritë sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë dhe për kushte të barabarta në trajtimin me bursë. Prioritet kanë nxënëset vajza. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, në pamundësi trajtimi me bursë të plotë, brenda planit të miratuar, mund të trajtojnë/miratojnë për nxënësit/studentët edhe 1/2 (gjysmë) burse.

6.1 Njësitë bazë të qeverisjes vendore, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se data 31.12.2015, institucioneve publike të arsimit të lartë, njësisive bazë të qeverisjes vendore, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

6.2 Njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e shkollave profesionale duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe bashkive që, sipas ndarjes territoriale, menaxhojnë konviktet, listën emërore të nxënësve dhe të studentëve përfitues të bursës, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të nxënësve dhe studentëve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, jo më vonë se data 15 janar 2016.

6.3 Drejtoritë e shkollave profesionale, për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2015-2016, në degët: Bujqësi, Veterinari, Pyjore, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe të gazit, u dërgojnë informacion Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe njësisive bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 15.11.2015.

6.4 Nxënësit e shkollave profesionale, që ndjekin vitin e dytë në drejtimit mësimor: Bujqësi, Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe të gazit, që kanë përfituar bursë në vitin e parë, 2014-2015, dhe nuk rezultojnë mbetës,

përfitojnë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit.

6.5 Njësitë bazë të qeverisjes vendore, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2015-2016, vendosin për dhënien e bursave sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale dhe konvikteve, në të cilat janë vendosur nxënësit, mbështetur në numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë. Drejtoritë e shkollave profesionale, menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).

7. Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit, nga këshilli i bashkisë, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore. Të gjithë nxënësit /prindërit dhe drejtoritë e shkollave profesionale dërgojnë/paraqesin, zyrtarisht, në njësitë e qeverisjes vendore, kërkesat për miratimin e bursës, për nxënësit që përfitojnë bursë, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.

Nxënësit që kanë përfituar bursë vitin e parë, me vendim të këshillit të bashkisë/komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, dhe nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike e nuk rezultojnë mbetës, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit. Nxënësit e viteve të III-ta të shkollave të mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe “Havzi Nela”, Kukës, të cilët transferojnë programet e nivelit të dytë në shkollat e mesme profesionale në Shkodër, pra nga njësitë vendore Bashkia Peshkopi dhe Bashkia Kukës, në njësinë vendore Bashkia Shkodër, transferojnë, njëkohësisht, zyrtarisht, në Bashkinë Shkodër, numrin e bursave që kanë përfituar nxënësit për vitin shkollor 2014-2015, sipas vendimeve të këshillit të njësisive vendore Bashkia Peshkopi dhe Bashkia Kukës.

Për nxënësit e tjerë të viteve të III-ta, të shkollave të mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe “Havzi Nela”, Kukës, që plotësojnë kriteret ekonomike dhe kriterin e largësisë nga vendbanimi, sipas pikës 2.1, kërkesat e tyre shqyrtohen dhe trajtohen me bursë nga njësia e qeverisjes vendore Bashkia Shkodër.



7.1 Nxënësit që kanë përfitur bursë e përfitojnë atë edhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore, nga njësia bazë e qeverisjes vendore, gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.

7.2 Nxënësve të klasës së 13-të, të shkollave profesionale, të drejtimin Termohidraulikë, që nuk kanë përfitur bursë me vendim të këshillave të njëjësive të qeverisjes vendore, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, të miratuar për vitin akademik 2015–2016, u akordohet/miratohet bursë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, mbështetur në kërkesën e drejtorëve të shkollave profesionale.

7.3 Bursat e akorduara/miratuara nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u dërgohen, zyrtarisht, njëjësive bazë të qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit që zhvillojnë praktikën profesionale. Nxënësit që përfitojnë bursë, kur nuk kanë mundësi akomodimi në konvikte dhe ofrimi të saj në formën e kuotës ushqimore, e përfitojnë bursën mujore në lekë, drejtpërdrejt në llogarinë bankare të nxënësit/prindit.

7.4 Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dëgjojnë, zyrtarisht, çdo muaj, pranë njëjësive bazë të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale, për nxënësit që përfitojnë bursë.

8. Bursat e studentëve, për vitin e II-të e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët e vitit të II-të e lart, që nuk kanë përfitur bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

8.1 Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë, sipas pikave 2.2 e 2.3, është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë), në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave, të dhëna për vitin akademik 2015–2016. Institucionet publike të arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kërkesat për studentët që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2, të këtij vendimi.

8.2 MAS-i harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët, të cilët kanë përfitur

bursë vitin e parë, me vendim të këshillit të bashkisë ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

9. Nga plani i bursave të miratuara për vitin akademik 2015–2016, Bashkisë së Tiranës i jepen deri në 15 (pesëmbëdhjetë) bursa për studentët, të cilët, pavarësisht nga kriteri i vendbanimit apo kriterëve ekonomike, kanë statusin ligjor të jetimit, të invalidit paraplegjik/tetraplegjik, që nuk shikojnë/nuk dëgjojnë, si dhe të kategorive të tjera, të përcaktuara në pikën 2.3, të këtij vendimi; ndërsa bashkive Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Kamëz, Shkodër dhe Vlorë, të cilat, në territorin e tyre kanë institucione publike të arsimit të lartë, për këtë kategori studentësh u jepen deri në 5 (pesë) bursa.

Nxënësit dhe studentët që kanë përfitur statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk shikojnë, përfitojnë falas: veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfitur statusin ligjor të jetimit, të invalid paraplegjik/tetraplegjik, statusin ligjor që nuk shikojnë/që nuk dëgjojnë u sigurohen, falas, akomodimi/fjetja, si dhe u mbulohen, nga fondet e institucioneve arsimore përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës, të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë, që vazhdojnë shkollat e mesme ose institucionet publike të arsimit të lartë, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokaluase, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

9.3 Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, që vazhdojnë studimet në shkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas: veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 6.



9.4 Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psiko-sociale, pa konvikt, trajtohen falas, nga shteti, me një kuotë ushqimore (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursa përlloraget si shpenzim mesatar, lekë në ditë, dhe paguhet çdo muaj, me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia/komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

10.2 Nxënësve që përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik, sipas rezultateve të arritura e sipas degëve parësore për zhvillimin e ekonomisë, si dhe nxënësve që përfitojnë bursë jashtë kriterit ekonomik, të cilët nuk janë akomoduar në konvikte, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet, çdo muaj, nga bashkia, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues.

10.3 Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive bazë të qeverisjes vendore, informacion për ndjekjen/frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli/masa e bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr. 2 e nr. 3, ndërsa kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr. 4 e nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për hyrjet e reja në vitin e parë, në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, për vitin e ri mësimor

2015–2016 të japë 1950 (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, për vitin e ri akademik 2015–2016 të japë 1800 (një mijë e tetëqind) bursa për studentët.

13. Efektet financiare të vitit akademik 2015–2016 të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për vitin 2015, për pjesën e vitit 2015, dhe nga fondet e buxhetit të shtetit, që do të miratohet për vitin 2016, për pjesën e vitit 2016.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 31 dhjetor 2015, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa, për vitin e dytë e lart, është data 30 nëntor 2015. Vendimet e miratuara nga këshillat e bashkive apo institucionet publike të arsimit të lartë jashtë këtij afati janë të pavlefshme.

15. Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive bazë të qeverisjes vendore janë miratuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi, por dërgohen jashtë afatit të përcaktuar, kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe të rivendosin në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive bazë të qeverisjes vendore dhe vendimet e institucioneve publike të arsimit të lartë bëhen publike për studentët, komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore, në faqen elektronike.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë bazë të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Pasqyra nr. 1

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS (VITI MËSIMOR 2015–2016)

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursa	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	deri 3,200	3,200-4,600	mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	deri 3,100	3,100-4,500	mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	deri 3,000	3,000-4,400	mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	deri 2,900	2,900-4,300	mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	deri 2,800	2,800-4,200	mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	deri 2,700	2,700-4,100	mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	deri 2,600	2,600-4,000	mbi 4,000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi bazë të qeverisjes vendore.

Pasqyra nr. 2

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2015–2016)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,165	200	6,365	0	6,365
	b) Gjysmëbursa	6,165	200	6,365	3,182	3,183
	c) Me pagesë	6,165	200	6,365	6,365	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe Arsimit Special					
	a) Bursa	6,683	200	6,883	0	6,883
	b) Gjysmëbursa	6,683	200	6,883	3,441	3,442
	c) Me pagesë	6,683	200	6,883	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,683	200	6,883	0	6,883

Pasqyra nr. 3

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2015–2016)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga studenti	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6,900	2,000	8,900	0	8,900
	b) Gjysmëbursa	6,900	2,000	8,900	4,450	4,450
	c) Me pagesë	6,900	2,000	8,900	8,900	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a) Bursa	7,410	2,000	9,410	0	9,410



b) Gjysmëbursa	7,410	2,000	9,410	4,705	4,705
c) Me pagesë	7,410	2,000	9,410	9,410	0

Pasqyra nr. 4

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE VITI MËSIMOR 2014–2015

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	30	93	150	4.5
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	gram	20	152	531	10.62
10	Mish	gram	70-80	115	750	52.5
11	Djathë	gram	25	40	400	10
12	Reçel	gram	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	12	12
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Patate	gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		206

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e në procesin e prokurimeve publike dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Pasqyra nr. 5

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE (VITI MËSIMOR 2015–2016)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gram	350-400	1,117	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	40	145	150	6
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	40	124	150	6
6	Perime	gram	120-130	27	100	12
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	40	360	180	7.2
9	Gjalpë	gram	20	152	531	10.62
10	Mish	gram	80-100	140	750	60
11	Djathë	gram	42	66	400	16.8
12	Reçel	gram	44	190	250	11
13	Patate	gram	200	170	40	8
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Vezë	kokërr	1	42	12	12



16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			3,037		230

Pasqyra nr. 6

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES
(VITI MËSIMOR 2015–2016)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7,000 (shtatë mijë) lekë
2	Për nxënësit romë dhe egjiptianë	7,000 (shtatë mijë) lekë
3	Për jetimët	10,000 (dhjetë mijë) lekë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 434 lekë